



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 07 -2009

Prishtinë, më 9 mars 2009, ora 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj Bajram Kosumi, Kolë Berisha Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq, Džezair Murati dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi - NDI, Isuf Zejna – KDI, Petrit Hysaj – OSBE dhe Yordan Sirakov - EULEX.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 2 marsit 2009;
3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-077/k të 5 marsit 2009 lidhur me shqyrtimin e propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Federatës së Gjahtarëve të Kosovës;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi nëngrupin për hartimin e strategjisë për monitorimin e Ligjit penal për të mitur, stafin Mbështetës të Administratës, organizatat që e mbështesin punën e Komisionit, si: NDI, OSBE, EULEX dhe mjetet e informimit etj.

Kryetari - I njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 2 marsit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje për procesverbalin.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e Armend Zemajt, që kërkoi të përfshihen pas fjalës forenzika, fjalët e organeve të punëve të brendshme, që duhet të jenë pjesë e këtij procesverbali.

3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-077/k të 5 marsit 2009 lidhur me shqyrtimin e propozimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryetari – Në këtë pikë të rendit të ditës tha se Kryesia e Kuvendit e ka shqyrtuar një propozim të Gjykatës Supreme më 3 mars 2009, që ka të bëjë me emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Kryesia e Kuvendit kërkon nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ta shqyrtojë propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime në seancën plenare të 12 marsit 2009. Këtu kemi të bëjmë me një emërim që do ta bëjë Kuvendi. Kjo është paraparë edhe në nenin 4 të Ligjit për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. Kjo çështje qartësohet edhe më mirë në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji.

Sqaroi se Kuvendi i Kosovës ka mundësi ta zgjedhë vetëm një anëtar. E kemi edhe një propozim nga Gjykata Supreme e Kosovës që anëtar të zgjidhet avokati Adem Vokshi. Biografinë e kemi para nesh. Ai ka punuar në gjykatë dhe është civilist, kurse tash është avokat. Ka kryer trajnime të ndryshme nga lëmi civil.

Neni 11 paragrafi 7.2 parasheh se anëtarët e Komisionit duhet të jenë ekspertë të fushës së Ligjit për banim dhe pronë, si dhe të jenë të kualifikuar për poste gjyqësore. Shtoi se kandidati i propozuar i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara me ligj. Për rekomandimin e këtij kandidati pati edhe diskutime të anëtarëve të tjerë të Komisionit.

Komisioni vendosi ta rekomandojë kandidatin Adem Vokshin për anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore në pajtim me kushtet e parapara me ligj.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Federatës së Gjahtarëve të Kosovës

Kryetari - Lidhur me kërkesën e Federatës së Gjahtarëve të Kosovës shtoi se kemi të bëjmë me kërkesën për ndryshimin e nenit 7 të Projektligjit për armët.

Ibrahim Makolli - Kërkesa e Federatës së Gjahtarëve për të pasur armë gjuetie nuk do të duhej patjetër të ishte kusht të bëhesh edhe anëtar i Shoqatës.

Bajram Kosumi - Veçoi se të gjithë ata që kanë armë gjuetie do të ishte mirë të anëtarësohen në Shoqatë, sepse kështu kontrolli i armëve do të ishte më i madh.

Adem Salihaj - Kjo çështje duhet të trajtohet më vonë, sepse ende nuk është miratuar projektligji.

Kryetari - Shtoi se për Federatën e Gjahtarëve do ta hartojmë një shkresë, në të cilën do të thuhet se ne si Komision për Legjislacion dhe Gjyqësi e kemi shqyrtuar kërkesën tuaj. Kur të miratohet projektligji Komisioni do t'i paraqesë amendamentet.

5. Të ndryshme

Kryetari – Para Komisionit shtroi çështjen e bazës juridike të Projektligjit për lizingun financiar. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara të fushëveprimit të vet, pas shqyrtimit të bazës juridike të Projektligjit të theksuar, rekomandon që Projektligji të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshëm për t'u miratuar në një nga seancat e ardhshme.

Në vazhdim të kësaj pike të rendit të ditës u diskutua mënyra e procedimit të Ligjit për të drejtat sendore, që është kthyer në Kuvend dhe ka numër të madh amendamentesh.

Kryetari – Mendojmë se amendamentet duhet të shqyrtohen kapitull për kapitull. Kjo ka bazë në Rregulloren e punës të Kuvendit.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni